

KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN NGA ZJARRI

Kushtet e përgjithshme të kontratës për Sigurimin nga Zjarri, këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit"

Siguruesi këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht Shoqëria e Sigurimeve INTERSIG - Vienna Insurance Group sh.a

I siguruari është person fizik, interesi pasuror i të cilit do të mbulohet sipas këtyre Kushteve të Sigurimit.

Përfutuesi është person fizik ose juridik, që ka ineters pasuror mbi objektin e siguruar dhe në dobi të të cilit lidhet kontrata e sigurimit.

FUSHA E MBULIMIT

1. Siguruesi dëmshpërblen të Siguaruarin për humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale si pasojë e:

- zjarrit;
- rufesë;
- eksplozionit;
- përplasi ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij;
- përjekjeve për shuarjen e zjarrit, prishjeve ose lëvizjeve në lidhje me çdonjerën prej ngjarjeve të mësipërme në kufirin deri në 3% të shumës së siguruar;

OBJEKTI I SIGURIMIT

2. Siguruesi ofron sigurimin nga zjarri për pasurinë e paluajtshme dhe pasurinë e luajtshme.

3. I siguruari duhet të ketë interes pasuror dhe ligjor mbi pasurinë objekt sigurimi.

4. Sigurimi i pajisjeve nuk do të përfshijë: kamionët, mjetet motorike, makinat e fatit, makinat automatike për thyerjen dhe tërheqjen e parave.

5. Objektet e mëposhtme do të sigurohen vetëm në kasaforta sipas llojit të përkthuar në kontratë:

- kartmonedha;
- dokumenta, letra me vlerë;
- monedha e medalje;
- metale të çmuara;
- gurë të çmuar;

6. Kartëmonedhat do të mbulohen gjatë orëve të punës deri në një shumë të përcaktuar shprehimisht në kontratë, pavarësisht se ato nuk janë vendosur në kasafortë, sipas llojit të parashikuar në kontratë.

PËRJASHTIME

7. Nuk do të mbulohen dëmet e mëposhtme:

- dëmtimi nga zjarri i objekteve të siguruar shkakuar nga vënia e tyre në zjarre utilitare (zjarre përdorimi ose shërbimi) ose nga trajtimi i tyre me ngrohje; kjo do të zbatohet gjithashtu për objektet në të cilat ose përmes së cilave prodhohet ose përmirësohet zjarri ose nxehtësia utilitare.
 - djegjet sipërfaqësore, përveçse kur shkaktohen nga një prej rreziqeve të mbuluara në nenin 10;
 - dëmi në motorët me djegie të brendshme shkakuar nga shpërthimet e ndodhura brenda dhomës së djegies.
 - dëmi i shkakuar në kontaktet e çelsave elektrike si rrjedhojë e presioneve të gazrave që lindin brenda tyre;
 - dëmi në çdo makineri dhe aparaturë elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik shkakuar nga rryma elektrike me ose pa ndodhjen e zjarrit (p.sh. si pasojë e mbrirymës, tejkalimit të kufijëve normale të tensionit, mbitensionit ose nëntensionit, defekteve të izolimit si qarqe të shkurtra, kontakte trupore ose difekte tokëzimi, kontaktit të pamjaftueshëm, mosfunksionimit të instalimeve të matjes, kontrollit ose sigurisë;
 - dëmi në çdo makineri dhe aparaturë elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik si pasojë e rufesës, nëse ky dëm nuk është shkakuar nga goditja direkte e rufesës;
 - dëmi nga zjarri, i cili shkaktohet nga tërmeti;
 - dëmi i shkakuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të Siguaruarit;
 - dëmi i shkakuar direkt ose indirekt nga veprimet (aktet) keqdashëse. Me veprime (akte) keqdashëse do të kuptohet humbja, shkatërrimi ose dëmtimi (shkakuar nga zjarri, eksplozioni ose veprime të tjera) e Pasurisë së Siguaruar shkakuar direkt ose indirekt nga dëmtimet keqdashëse të çdo personi ose grup personash, pavarësisht nëse një akt i tillë është bërë ose jo si pasojë prishjes së qetësisë publike.
 - dëmi i shkakuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e anëtarëve madhorë të familjes së të Siguaruarit;
8. Ky sigurim nuk do të mbulojë dëmtimin e objekteve të siguruar ose shpenzimet e siguruar të lindura ose të shkaktuara drejtpërsëdrejtë ose indirekt si pasojë e:
- shpërthimit bërthamore, rrezatimit bërthamor ose ndodhjes radioaktive;
 - luftës së çdo lloji, invazionit, luftime të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, luftën civile.
 - turbullira civile, revolucione, lëvizje separatiste, kryengritje popullore, rebelime, revolta, grusht shteti, eksode;
 - konfiskime, rekuizime, shtetëzime të detyruara të kryera me urdhër të çfarëdo lloji qeverie ose autoriteti shtetëror;
 - trazirat, greva, sabotimi, terrorizmi. Terrorizëm do të konsiderohet kryerja e veprimeve të dhunshme ndaj pasurisë nëpërmjet vjedhjeve, dëmtimeve e shkatërrimeve masive që kanë si qëllim turbullimin e rendit publik dhe ngjalljen e frikës e të pasigurisë së publikut;

f) shpalljen e ligjit të luftës, deklarimit dhe vendosjes së gjëndjes së jashtëzakonshme, anarkia ose mosfunksionimi i shtetit, qoftë edhe në pjesë të caktuara të vendit.

9. Vlera dhe shumta e siguruar, Neni 1136 Kodi Civil.

Në qoftë se vlera aktuale është më e vogël se 80% e vlerës së zëvendësimit, shumta e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën aktuale.

Në qoftë se vlera e tregut është më e vogël se vlera aktuale, shumta e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën e tregut.

10. Në këtë mbulim në sigurim do të përdoret sistemi proporcional i dëmshpërblimit.

11. Nuk do të mbulohet fitimi i munguar dhe dëmet vijuese të çdo lloji dhe natyre të tilla si dëmet për shkak të vonesave, moskryerjes, humbjes së kontratës, gjobat, etj.

12. Nëse organet e Policisë (ruajtjes së rendit) nuk janë njoftuar për dëmtimet ose objektet e humbura, Siguruesi ka të drejtë të çlirohet nga detyrimi i tij.

PJESA E ZBRITSHME

13. Për çdo dëmi Siguruesi do të zbrisë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në Policën e Sigurimit në shumën absolute ose përqindje.

14. I siguruari do të njoftojë për ekzistencën e mbulimeve të tjera mbi pasurinë, në rast të kundërt Siguruesi çlirohet nga detyrimi për të dëmshpërblyer.

NGAJRJA E SIGURIMIT

15. Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, i Siguaruari duhet;

- të njoftojë menjëherë Siguruesin, brenda 24 orëve, si dhe të njoftojë organet e rendit e njësitë zjarrfikëse;
- të japë menjëherë rajonit të policisë një listë të objekteve të dëmtuara;
- të shmang ose minimizojë humbjet ose dëmtimet me sa është e mundur dhe gjatë këtyre veprimeve të ndjekë udhëzimet e siguruesit. I Siguaruari është i detyruar të kërkojë dhënien e këtyre udhëzimeve nëse lejojnë kushtet;
- të bllokojë librat e llogarisë dhe dëshmi të tjera të pasurisë së tij;
- të lejojë siguruesin me kërkesën e tij dhe për sa është e arsyeshme të hetojë lidhur me shkakun dhe shumën e humbjes si dhe masën e dëmshpërblimit duke i dhënë çdo informacion që ndihmon hetimin;
- nëse është e mundur të mos ndryshojë asgjë në vendëngjarje, pa miratimin e Siguruesit;
- të dorëzojë brenda 5 ditëve nga ndodhja e ngjarjes një listë të firmosur të gjitha objekteve të humbura, dëmtuara apo shkatërruara, sipas formularit të dhënë nga Siguruesi, si dhe vlerën për të cilën kërkon të shpërblehet.

16. Nëse i Siguaruari, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton tërësisht ose pjesërisht detyrimet e mësipërme në lidhje me detyrimet për njoftimin e ngjarjes së siguruar, Siguruesi çlirohet nga përbushja e detyrimeve të tij.

17. Nëse organet e policisë (të ruajtjes së rendit) nuk janë njoftuar në kohë për objektet e humbura apo dëmtuara, Siguruesi ka të drejtë të çlirohet nga detyrimi i tij për këto objekte.

DËMSPËRBLIM

18. Nëse i Siguaruari përpiqet të paraqesë në mënyrë të shtrëmbër ose mashtruese faktet para Siguruesit, fakte të cilat kanë rëndësi për mundësinë ose masën e dëmshpërblimit. Siguruesi do të çlirohet nga detyrimet e tij.

19. Detyrimi i Siguruesit për dëmshpërblim kufizohet deri në masën e shumës së siguruar. Dëmshpërblimi maksimal që do të paguaj Siguruesi për çdo dëm nuk do të kalojë shumën e siguruar të rënë dakort për secilin objekt.

- për ag kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguaruarit për tmarrë pagesën.
- në qoftë se janë filluar hetimet penale kundër të Siguaruarit në lidhje me ngjarjen e sigurimit.
- për aq kohë sa i Siguaruari nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi.

21. Në qoftë se detyrimi i Siguruesit për të paguar dëmshpërblimin dhe vlerën përkatëse të tij janë shqyrtuar, pagesa duhet të bëhet brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit.

22. Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguaruarin për dëmin duke paguar me para, duke riparuar ose zëvendësuar sipas zgjedhjes së Siguruesit.

23. Mosmarrveshjet, në qoftë se nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga gjykata e vendit ku është lidhur Polica e Sigurimit.

POLICA, PRIMI DHE PERIUDHA E SIGURIMIT

24. Siguruesi lëshon Policën e Sigurimit dhe përcakton primin e sigurimit në bazë të formularit të Bankës, Kërkesës për Sigurim dhe deklarimeve të bëra nga i siguruari.

25. Mbulimi në sigurim fillon në orën 24.00 të datës së përcaktuar si ditë e fillimit në Policën e Sigurimit, me kusht që të jetë paguar më parë primi i sigurimit ose kësti i tij i parë.

26. Mbulimi në sigurim përfundon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë e mbarimit në Policën e Sigurimit.

27. Pagesa do të quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë e Siguruesit. Ky polica e sigurimit është lidhur me një periudhë disa vjeçare, primi i sigurimit do të paguhet me këtë vjetore.